



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit
P- 23
Prishtinë, më 14 korrik 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 14 KORRIK 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme të jashtëzakonshme plenare:

- **Debat parlamentar lidhur me dialogun e Qeverisë të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë dhe marrëveshjet e arritura në këtë dialog, sipas kërkesës së GP LDK, GP LVV dhe GP AAK**

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të pikës së vetme të rendit të ditës, konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë dhe tha se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kanë paraqitur kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të diskutuar lidhur me dialogun e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë dhe marrëveshjet e arritura në këtë dialog.

Kryetari ftoi deputetin, **Ismet Beqiri**, për prezantimin dhe arsyetimin e kërkesës për mbledhje të jashtëzakonshme.

Ismet Beqiri, në fillim të fjalës së tij tha se kërkesën për seancë të jashtëzakonshme të tri grupet parlamentare opozitare e kanë paraqitur dhe arsyetuar në formë të shkruar. Në vazhdim, tha se pas diskutimeve që do të pasojnë, veçmas nga deputetët e tri grupeve parlamentare opozitare, do të propozojmë rekomandimet konkrete për votim në mbledhje plenare.

Në vazhdim, **Ismet Beqiri**, foli në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe tha se si grup parlamentar kemi shprehur rezervat tona lidhur me mënyrën e fillimit të këtyre bisedimeve dhe i kemi vlerësuar të papërgatitura mirë.

Këto bisedime nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës po cilësohen si teknike ndërsa nga ndërkombëtarët si politike, tha ai.

Më tej, duke folur për rezultatin e deritanishëm të këtyre bisedimeve, deputeti Beqiri shfaqti dilemat e paraqitura rreth emërimit të këtij rezultati, nëse këto quhen marrëveshje apo konkluzione ndërmjet palëve.

Për Grupin Parlamentar të LDK-së, bisedimet Kosovë-Serbi kanë kuptim atëherë kur marrëveshjet e arritura ndërmjet palëve ratifikohen në Kuvend, ndërsa zbritja e formatit të rezultatit të bisedimeve nga marrëveshjet në konkluzione është e pa kuptimtë dhe indikative, konstatoi ai.

Më pas, deputeti Beqiri u fokusua në përmbajtjen e këtyre konkluzioneve, për të cilat tha se sido që të quhen ato, përmbajtja e këtyre konkluzave është akoma më shqetësuese, ngase ato çojnë në zbehje në disa aspekte të sovranitetit shtetëror dhe të organizimit të brendshëm të shtetit të Kosovës, siç është rasti me tabelat e regjistrimit RKS – KS, kufiri shtetëror quhet kufi administrativ etj.

Duke folur për konkluzionet lidhur me regjistrat e gjendjes civile, deputeti Beqiri theksoi faktin se edhe me këta regjistra Serbia po sillet sikur të jetë padron në Kosovë, për të shtruar më pas pyetjen se si mund të ketë dy regjistra të gjendjes civile, njëri origjinal e tjetri kopje.

Grupi Parlamentar i LDK-së insiston të bëhet pezullimi i këtyre bisedimeve, të caktohet platformë e qartë dhe e përgatitur mirë për këto bisedime dhe rezultatet e marrëveshjeve të arritura të ratifikohen në Kuvend, tha deputeti Ismet Beqiri.

Në fund, deputeti Ismet Beqiri propozoi që rekomandimi për pezullimin e bisedimeve Kosovë –Serbi të hidhet në votim në mbledhjen e sotme plenare, pas diskutimeve të zhvilluara.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Adem Grabovci**, në fillim të fjalës së tij tha se Kosova po kalon në një etapë e cila kërkon seriozitet nga të gjithë ne, si në raport me qytetarët, por edhe në raport me miqtë tanë, BE-në dhe SHBA-të. Në këtë drejtim, objektiv i politikës shtetërore është edhe ndërtimi i marrëdhënieve të mira me të gjithë fqinjët, por edhe me Serbinë, tha ai.

Në vazhdim, deputeti Grabovci, tha se duhet të mbështetemi në Rezolutën e këtij Kuvendi, me të cilën iu jepet përkrahje bisedimeve Kosovë-Serbi, por njëkohësisht duke qenë të kujdesshëm për elementet e sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës.

Më tej, ai u fokusua në partneritetin e Kosovës me miqtë tanë, me ç'rast tha se ky partneritet na duhet sot, po aq sa na është dashur në kohën e çlirimit të Kosovës. Duke folur për garancitë ndërkombëtare rreth këtyre bisedimeve, ai përmendi deklaratën e nënpresidentit amerikan Biden për përkushtimin e SHBA-së për sovranitetin e Republikës së Kosovës dhe angazhimet e shtetit shqiptar përballë procesit të bisedimeve Kosovë-Serbi.

Pavarësisht ndjenjave të secilit, një ditë do të ndodh njohja reciproke në mes dy shteteve dhe ne kemi obligim që të kontribuojmë në lehtësimin e këtyre proceseve ndërshtetërore, konstatoi deputeti Grabovci.

Duke folur për konkluzionet e bisedimeve Kosovë-Serbi, ai shprehu bindjen se ato paraqesin fillimin e fundit të funksionimit të strukturave paralele serbe në Kosovë.

Në fund, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së tha se e mbështesim delegacionin e Republikës së Kosovës në këto bisedime dhe besojmë në rekomandimet e miqve tanë lidhur me këto zhvillime.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, **Visar Ymeri**, në fillim të fjalës së tij tha se në çdo proces negociator Kosovë - Serbi, debati kryesor ka konsistuar në përmbajtjen e atyre bisedimeve, ndërsa tash më shumë po flitet për formën se sa për përmbajtjen.

Çështja është se a janë palë të barabarta në këto bisedime Republika e Serbisë dhe Kosova pa sovranitet, tha deputeti Ymeri, për të theksuar më pas se Qeveria e Kosovës po i fsheh nga publiku këto tri marrëveshje.

Në vazhdim, duke folur për marrëveshjet e arritura, ai tha se tri marrëveshjet e para janë më të lehta dhe janë bërë në fillim, ndërsa ato që do të pasojnë, do të shprehin më tepër cenimin e sovranitetit të Republikës së Kosovës.

Më tej, ai u fokusua në përmbajtjen e marrëveshjeve, me ç’rast theksoi se ajo për regjistrat e gjendjes civile nënkupton zhbërjen Kushtetutës së Kosovës dhe të sovranitetit të saj, pastaj në ato konkluzave ne trajtohem si banorë, por jo edhe si qytetarë, ndërsa te pika nr. 3. e konkluzave, në fusnotën e saj përmendet gjuha neutrale.

Deputeti Ymeri, më pas bëri një elaborim veç e veç pothuaj të të gjitha pikave të konkluzioneve të arritura.

Në fund, kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” konstatoi se grupi parlamentar që ai përfaqëson, është i mendimit se për sa kohë që Serbia nuk e njeh Kosovën, edhe ne nuk do ta njohim atë, ndërsa Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të jetë garant i kushtetutshmërisë dhe i zbatimit të ligjit në Kosovë.

Në fund, deputeti Visar Ymeri propozoi që rekomandimi për pezullimin e bisedimeve Kosovë –Serbi të hidhet në votim në mbledhjen e sotme plenare, pas diskutimeve të zhvilluara.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në fillim të fjalës së tij tha se përkrah rekomandimet e paraqitura për votim nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Përmes këtyre bisedimeve ne po tregojmë se nuk kemi të ndërtuara interesat tona strategjike, Qeveria e ka sjellë vendin në pozitë të pabarabartë në këto bisedime, sepse tashmë është e qartë se nga këto bisedime Serbia do të fitojë statusin e shtetit kandidat për në BE, ndërsa mbetet e padefinuar se çka fiton shteti i Kosovës nga këto bisedime, theksoi deputeti Gjini.

Në vazhdim, ai tha se integrimet në BE nuk paraqesin ndonjë frazë, por ky proces i ka fazat e veta të zhvillimit.

Më tej, ai theksoi se Qeveria e Kosovës duhet të shpjegojë se si do të na njohë Republika e Serbisë përmes këtyre bisedimeve, aq më parë kur ne edhe në të kaluarën kemi hequr dorë prej shumë sendeve, qoftë edhe me çmim të jetës, vetëm për të hequr sovranitetin e Serbisë nga Kosova, ndërsa si shembull të keq ne sot bëjmë lëshime dhe pranojmë kopjet e regjistrave të vjedhur gjatë kohës së okupimit nga ana e shtetit serb në Kosovë.

Më pas, ai u fokusua në domosdoshmërinë e ratifikimit të marrëveshjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke shtruar pyetjen se nëse këto marrëveshje janë të mira dhe

në interesin e qytetarëve të Kosovës, atëherë pse ato nuk procedohen në Kuvend për ratifikim.

Në fund, kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, konstatoi se interesi i Kosovës nuk është dialogu me Serbinë, pa zhvillim ekonomik të vendit, pa zbutjen e papunësisë, pa një arsimim kualitativ dhe pa shërbime cilësore në shëndetësi.

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, **Gëzim Kelmendi**, në fillim të fjalës së tij, pasi i dha mbështetje iniciativës për këtë mbledhje të jashtëzakonshme, kërkoi që të respektohet Rezoluta e aprovuar në Kuvendin e Kosovës lidhur me këto bisedime dhe respektimin e parimeve të dala nga kjo rezolutë.

Ai, në fund kërkoi që BE t'i trajtojë të barabartë si Serbinë, ashtu edhe Kosovën në procesin e integritetit evropian.

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Petar Miletqi**, në fillim të fjalës së tij tha se si subjekt politik e kemi përkrahur dialogun në mes dy shteteve dhe në këtë Parlament kemi votuar Rezolutën lidhur me këto bisedime.

Në vazhdim, ai tha se brengë e jona është transparenca jo e mjaftueshme mbi këto bisedime.

Më tej, ai shfaqti mirënjohje për BE-në dhe SHBA-në për lehtësimin e këtij dialogu dhe konfirmoi mbështetjen e partisë që ai përfaqëson në të mirë të këtij dialogu.

Hashim Thaçi, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në fillim të fjalës së tij falënderoi propozuesit për debat lidhur me çështjen e bisedimeve Kosovë-Serbi dhe shfaqti bindjen e tij se sqarimet që do të jepen në këtë debat, do të hasin në mirëkuptimin e propozuesve.

Ai, në vazhdim tha se dialogu dhe fqinjësia e mirë janë vlera të panegociuara si për ne, ashtu edhe për vlerat e botës demokratike, BE-së dhe SHBA-së, prandaj as populli i Kosovës dhe as Qeveria e saj nuk kërkojnë aleatë të tjerë dhe se ne do të thellojmë partneritetin me aleatët tanë strategjikë ndërkombëtarë.

Më tutje, ai tha se dialogu ndërshtetëror me Serbinë është edhe obligim ndërkombëtar dhe ne atë e shohim në kontekst të ndërtimit të marrëdhënieve të mira me të gjithë fqinjët.

Kërkesën për pezullim të bisedimeve kryeministri i vendit e quajti kërkesë për izolimin e Kosovës, duke qenë shumë të vetëdijshëm se raportet me Serbinë janë shumë komplekse, por atë nuk bën ta shfrytëzojë askush për marketing politik, me ç'rast ai ftoi opozitën që të ndihmojë në procesin e dialogut në mes dy shteteve.

Kryeministri Thaçi, më tej shprehu bindjen e plotë se procesi i dialogut me Serbinë është proces i dy palëve të barabarta dhe se kështu do të jetë edhe në të ardhmen, ndërsa në lidhje me proceset integruese në BE theksoi se tashmë Serbisë i është bërë e ditur se pa rregullimin e raporteve të mira ndërqinjësore nuk mund të bëhet pjesë e këtyre proceseve.

Kryeministri, në vazhdim i bëri një elaborim të veçantë konkluzioneve të ndërmjetësit të BE-së në dialogun Kosovë – Serbi, për të cilat konstatoi se nuk ndërhyjnë në elementet e sovranitetit shtetëror të Republikës së Kosovës, pastaj u ndal në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës lidhur me këto bisedime, duke potencuar me theks të veçantë vijat e kuqe për Qeverinë e Kosovës, të cilat dalin nga kjo rezolutë karshi bisedimeve me Serbinë.

Në fund, kryeministri kërkoi nga të gjithë që t'i ndihmohet Qeverisë së Kosovës në rezultatet konkrete të këtij dialogu dhe inkurajoi deputetët për një debat konstruktiv, duke qenë në dispozicion të këtij debati.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të vetme të rendit të ditës dhanë deputetët: **Ismet Beqiri**, kryeministri **Hashim Thaçi**, **Ardian Gjini**, **Shaip Muja**, **Skender Hyseni**, **Albin Kurti**, zv. kryeministrja **Edita Tahiri**, **Blerim Shala**, **Lutfi**

Haziri, Arsim Bajrami, Glauk Konjufca, Fadil Demaku, Ahmet Isufi, Teuta Sahatqija, Ganimete Musliu, Liburn Aliu, Donika Kadaj-Bujupi, Hykmete Bajrami, Ramiz Lladrovci, Rexhep Selimi, Idriz Vehapi, Time Kadrijaj, Hydajet Hyseni, Sadri Ferati, Niazi Idrizi, Burim Ramadani, Afrim Kasolli dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryeministri Hashim Thaçi, në fund të diskutimeve ri theksoi vijat e kuqe për Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me këto bisedime.

Deputeti, Ismet Beqiri, në fund të diskutimeve falënderoi deputetët për diskutimet e zhvilluara në Kuvend për këtë çështje dhe kërkoi që të vihet në votim propozimi i tri grupeve parlamentare për pezullimin e bisedimeve me Serbinë.

Deputeti Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi që propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës të mos vihet në votim, me arsyetimin se në kërkesën për mbledhje të jashtëzakonshme të parashtruar nga këto tri grupe parlamentare mungojnë rekomandimet për votim.

Deputeti Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se sipas Rregullores së Kuvendit, propozimi i propozuesit duhet të vihet në votim.

Kryesuesi, Xhavit Haliti, hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	46,
Kundër-----	37,
Abstenime-----	2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, që propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” dhe të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për pezullimin e bisedimeve me Serbinë, të mos vihet në votim.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18 : 00.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale